



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr.016-126211, të dt. 06.11.2014 me ndryshime dhe plotësime në Statut 01. nr.016—28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës në Cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ merr:

V E N D I M
P Ë R
ANULIMIN E SHPALLJES PËR REKRUTIM

1. **Anulohet**, Shpallja për rekrutim nr. 02-016-31104 të datës 22.03.2022 e publikuar përmes SIMBNJ-HRMS dhe Web faqes Komunale për plotësimin e pozitës punuese: **Drejtor i Teatrit të Qytetit** dhe të gjitha veprimet që kanë rrjedh nga kjo procedurë rekrutuese.
2. Anulimi i Shpalljes për rekrutim nga pika 1 e këtij vendimi bëhet, për shkak se Vendimi për emërimin e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit nr.02/244 i datës 04.04.2022 nuk është në harmoni me nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për Teatrot Nr.04/L-106, sepse njëri prej pesë (5) anëtarëve të këshillit duhet të jetë përfaqësues i Komunës.
3. Rekomandohet, Njësia për personel që Shpalljen për rekrutim ta përsërisë pas emërimit të Këshillit Drejtues të Teatrit sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Teatrot Nr.04/L-106.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
5. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.



Vendimi t'i dorëzohet:

- KDT
- Aplikantëve
- NJP